

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 04.03.2025, ora 11:22 në ambjentet e qëndrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Mirëseerdhët në mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak. Ftoj sekretarin të bëj apelin.

### **Enerieta Ferra-Zv Kryetare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Znj. Enerieta Ferra bën apelin present në sallë janë 42 antarë.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës.

*Pika e parë miratimi i rendit të ditës.*

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

I keni të gjitha njoftimet nëpër dosje është nevoja ta diskutojmë apo ta hedhim në miratim

### **Hektor Ciftja-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ndjesë, unë nuk kam këtë memon për krijimin e një landfilli.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Askush nuk e ka atë por ne ramë dakord që ta vem tek të ndryshmet.

### **Hektor Ciftja-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Me kë re dakord?

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Tek mbledhja e komisioneve ramë dakord ,që ta diskutojmë dhe ta përgatisim.

### **Hektor Ciftja-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Eshtë me rëndësi kjo nuk diskutohet, si të doni.

### **Zamir Muzhaqi-Nënkryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Dhe në kryesi dhe në komisione cështja e grumbullimit të mbetjeve urbane është bërë shumë serjoze. për procedurë do të jeni të gjithë dakord të diskutojmë dhe ti japim një mbështetje ECO-elbit sepse bën një projekt vetë ECO-elbi për shtimin e një landfilli të ri, pra projektin po e bën vet në si këshill bashkiak ti japin një shtysë që ta cojmë ne instancat. ministri që të bëhet landfilli, pra kjo është ideja që të biem të gjithë dakord që tja bëjmë këtë favor Eco-elbit sepse vet me forcat e veta po bën një projekt për një landfill të ri.

### **Hektor Ciftja-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kjo do të thotë që inceneratori del jashtë loje.

### **Zamir Muzahqi-Nënkryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Inceneratori është jashtë loje. Të llojmë që të marrim ato lekë dhe të bëhet landfilli i ri kaq.

### **Ilirjan Sadiku-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Për procedurë sepse është në rendin e ditës, ktu shkruhet një 2500 lekë për ton por e mira do të ishte të kishim një analizë të detajuar se po i marrim këto lekë po ca do bëhet me këto lekë se do të marrim një ton që janë tulla dhe beton ka dhe një ton që janë shkarpa që krasisin njerëzit. Këtë lloj analize duhet ta kemi. Pika 8 nuk është e detajuar, ta heqim nga rendi i ditës të na vi materiali pastaj që të mos e votojmë kundër më mirë e heqim nga rendi i ditës dhe herës tjetër të na e sjellin të detajuar.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Cfarë propozon, ti propozon që pika 8 meqë nuk është e detajuar të hiqet nga rendi i ditës dhe të sillen mbledhjen tjetër.

### **Ilirjan Sadiku-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Të gjithë ne të majtë të djathtë do të ishte shumë mirë që ne ti hynim një analizë të detajuar por aman ta kemi iden e kostos të kemi një material më të detajuar. Ti japim kohë, o te na e sjellin materialin e detajuar si do ti perdorin këto para dhe pastaj ne të kemi një ide të plotë

### **Dritan Ceca-Anetar i Keshillit Bashkiak Elbasan**

I bashkohem mendimit të Z.Sadiku për të vetmen arsye sepse minimalja është analiza e Kostos ndërsa ajo që është me thelbësorja në një nga pikat, nga nenet diskutohet depozitim trajtim inxhenerim, praktikisht inxhenerimi në dijenin time dhe tonën ka shumë kohë që nuk bëhet, tani në këtë analizën e Kostos, sa peshë për ton zë inxhenerimi, te cilat janë kosto specifike për mbetje organike për mbetjen plastike. Këshilli mbikqyrës I Eco -elbit e ka detyrim ligjor të na japë një analizë të detajuar kostoje sepse vendimi jone është titull ekzekutiv dhe kontrata nënshkruhet edhe kalon në marrëdhënie financiare

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Te kuptova, je në një linjë me Z.Illir, ta mbyllim këtë pikë, kush është pro që të hiqet e të ngelet muajin që vjen

### **Doris Madhi-Anetar i Keshillit Bashkiak Elbasan**

A ta diskutojmë çfarë do kërkojmë dhe ta bëjmë memon bashkarisht.

### **Erion Murataj-Anetar i Keshillit Bashkiak Elbasan**

Zoti Kryetar te pjesa e kontratës, unë nuk e kuptoj sika mundësi që kjo sallë e këshillit bashkiak ndërkohe që jo më larg se një vit më parë e ka votuar unanimitisht sot paska audicion. Është e qartë se janë prishur raportet dhe kërkesa e shumë anëtarëve të këshillit bashkiak për raportin e inxhenerimit me depozitimin ka qenë dhe vjet, sot cuditërisht ky krahu këtej qenka zgjuar. Kontrata e Eco-elbit ka kaluar dhe vjet, ka qe me të gjitha termat

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Nuk ke të drejtë fare të diskutosh me atë që propozoi ai, çfarë mendimi ke?

### **Erion Murataj-Anetar i Keshillit Bashkiak Elbasan**

Kjo kontratë duhet të ketë përfaqësuesin e Eco-elbit këtu.

### **Ermira Urupi -Anetar i Keshillit Bashkiak Elbasan**

Z.Lala a ka mundësi të merret në konsideratë propozimi ?

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ca mendimi ke te shtohet tek kjo qe tham?

**Erion Murataj-Anetar i Keshillit Bashkiak Elbasan**

Kjo kontratë duhet të rivotohet

**Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Pikërisht,unë po hedh në votim këtë që thash,meqë ne jemi në një linjë pak a shumë,meqë ka nevojë për të detajuar cdo lloj kosto grumbullim përpunim ineceratore.Kush është pro propozimit të Z.Illir dhe atë që tha edhe Z.Dritan ,kush është pro që të hiqet nga rendi I ditës edhe të shtohet muajin që vjen?Pëefaqsesit e Bashkisë le të merren me atë,të plotësojnë kërkesat qe diskutuat

**Valbona Balliu-Anetar i Keshillit Bashkiak Elbasan**

Cfarë do kërkojmë,cfar do Z.Sadiku?

**Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Z.Sadiku do koston për secalin zë që thuhet te kontrata.Cfar kërkohet gje tjetër thoni

**Valbona Balliu-Anetar i Keshillit Bashkiak Elbasan**

Pse nuk ka ardhur ky raport ,se pikërisht këtë kërkohet të miratohet kjo kontratë dhe nuk kan sjelle asnjë raport.Si ka mundësi ,po pse cfarë jemi ne,cfarë është ky këshill për formalizëm duhet te kishte ardhur një raport I detajuar nga drejtoria përkatëse

**Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

meqë ska ardhur do hiqet

**Doris Madhi-Anetar i Keshillit Bashkiak Elbasan**

Jo jo nuk do hiqet ,do diskutohet

**Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Atëhere hiqet nuk hiqet atë e vendos këshilli.Kush është pro të hiqet pika 8 edhe të shtohet muajin që vjen,te votoje

**Hektor Ciftja-Anetar i Keshillit Bashkiak Elbasan**

Ajo që po kuptohet ktu është të hiqet nga rendi I dites sot e te vendoset në rendin e ditës të muajit të ardhshëm ,ctë keqe ka qe te mblidhen shenimet edhe te opozitës

edhe të anës tjetër të Z.Illir edhe të trajtohen muajin e ardhshëm. I shkruani edhe I trajtojme muajin e ardhshëm

### **Ergys Muzhaqi-Anetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kam një propozim tjetër, nuk është çështja thjesht të hiqet ky propozim i këtij muaji dhe ta kalojmë muajin tjetër, kjo çështje e iniceneratorit, djegësit të Elbasanit aferë e pastër korruptive kriminale, e vërtetuar edhe nga organet qendrore të akuzës edhe nga ne këtu që nuk e kemi vutu vit mbas viti të punës, edhe nga përfaqësuesit që nuk arrijnë dot të na japin shpjegim qoftë edhe teknik. Nuk jam dakort që kjo të trajtohet si një teknikalitet, pra paskemi 2500, po pse e kemi 2500? Ta kemi ndryshe në vetvete po nuk mjafton. Prej bashkisë unë pres vetëm të sjelli që nëse kanë marrë votën prej qytetarëve të Elbasanit dhe po i kancerizojnë ditë për ditë e vit për vit me atë djegësin, që po i hedhin gjithë ato mbeturinat në lumë, mbetjet toksore nëntoksore në ajër se është vetëm pak metra larg qendrës së banorëve që është aty në katund të ri Bradashesh. Duhet të vij vetëm një propozim jo këtë muaj edhe muajin tjetër kur të doni ju. Zgjidhja e alternativës se këtë e morëm vesh që është korrupsion i gjallë. Nuk më interesojnë mua se pse relacionet pse kushtojnë kaq toni apo aq toni. Unë e di që afëra e Elbasanit është një mal i ri një Krastë e re me plehra të ndyra dhe ju sot me vini këtu ta diskutojmë ta heqim sot ta vendosim muajin tjetër se na duhet një relacion. Te kontrata që keni propozuar keni aty një pikë të turpshme që thotë kjo situatë mund të ndryshojë në qoftë se situata e firmës ndryshon në raport me shtetin, në qoftë se shteti i fut në burg ato dhe e mbyll si firmë hajde të votojmë prap në këtu, ky është turp më së pari dhe i sillni si propozim

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ok, E mora dhe pyetjen dhe mesazhin

### **Dritan Cepa-Anetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Këtë pyetje ja drejtoj Bashkisë së Elbasanit meqë do vij muajin tjetër materiali na duhet një relacion shtetëror për zbatimin e kontratës së vitit 2024, si është monitoruar kjo kontratë dhe si janë bërë likuidimet financiare duke patur parasysh që incinerimi nuk është bërë në 340 ditë të vitit gjatë 2024, ai ka punuar vetëm 22 ditë. Ju lutemi bashkisë që të jeni seriozë në këtë kërkesë. Faleminderit

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ok.gje tjeter per procedure?

### **Artan Kana-Anetar i Keshillit Bashkiak Elbasan**

Une isha pergatit qe per pikën 8 të diskutoja se kjo është një pikë e nxehtë ,nuk mund të kaloje kështu dhe unë propozoj se I foli parafolsi ato gjëra që unë I ve firmën që kjo është një kontratë korruptive dhe ne si opozitë vazhdimisht e kemi votuar kundradhe ata të cilët e votuan pro le ti dalin pëe Zot sot ,nuk është kaq e thjeshtë ta heqësh si pikë .Përderisa e sollët në rendin e ditës nuk kishit pse ta kalonit kështu po pat veprimet e prokuroris që ka hap për Eco-elbin dhe gjetët marifetin tek teknalitetet.Kontrata tjetër qe do nënshkruhet të jetë një operator serioz .Bashkia ka demonstruar që nuk mund ta kryej këtë proces,bëri kompaninë e pare qeveria ,ajo shkoi në Spak ,u bë kompania e dytë e ka marr prokuroria e Elbasanit ,do bëni kompanin e tretë nuk e di kujt prokurorie do ti bie ta marri ,ta marri Strasburgu ,kshuqë duhet të jemi serioz në hartimin e një plani të mirëstudiuar për këtë pike,mos flas në emrin politikan nuk dime nga gjërat teknike ,mos na fusni në teknalitete sepse kto jan gjëra që ju doni të ngatrroni njerëzit .Politikisht po flas që duhet një kontratë e mirëstudiuar nga një firme a nga një shtet që di të menaxhoj mbetjet sepse ne nuk kemi mundësi sic po e demonstrojmë dita ditës të heqim mbetjet e qytetit por është edhe mënyra sesi hiqen ,detajet bëjnë diferencën kshuqë propozimi me memo që do të vijë herës tjetër të jetë I studiuar,te konsultohet edhe te opozita,të mos kalohet me forcën e kartonit se ja ku jemi me gjërat që kemi kaluar me forcën e kartonit dhe ju nuk I dilni per Zot .Elbasanit këtë të keqe ja keni bër ju dhe mbani pergjegjësi.

### **Asim Sula-Nënkryetari i Bashkisë Elbasan**

E shof shumë të rëndësishme një çështje që është delikate por që është një shërbim shumë I rëndësishëm në qytetin e Elbasanit çështja e mbetjeve urbane që na prek çdo ditë,dhe kur propozohet nga pozita sidomos të kërkohet një analizë e detajuar përse I përket Kostos së shërbimit të mbetjeve të ngurta urbane është përgjegjësi për funksionimin e këshillit bashkiak.Ta konsiderojmë këtë si njësi të rëndësishme dhe që ky këshill të jet sa më konstruktiv dhe të marrë vendime të sakta dhe të rëndësishme.Ta shohim në këtë këndvështrim,në këtë aspekt.

Nga shumica juaj kuptova që të kemi shumë detaje dhe më shumë hollësi për mënyrën e funksionimit të Eco-elbit .Ta shofim si një risi positive shënimet

Përderisa shumica e këshillit bashkiak vendosi ta heqi nga rendi I ditës do të diskutohet ne rradhën e ardhshme.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ateher afarë ka tek rendi I ditës ndonjë gjë të përvec pikes 8?Une propozoj ta votojme rendin e ditës duke hequr pikën 8.Kush është pro?

### **Doris Madhi-Anetar i Keshillit Bashkiak Elbasan**

Ta hedhim poshtë me votë jo ta heqim nga rndi i ditës.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Drejtuesi I mbledhjes ka te drejtë të propozojë këshillit të votohet rendi I ditës,këshilltarët kan të drejtë të shtojnë apo të heqin.Kush është pro rendit të ditës duke hequr pikën 8?Kush është kundra?Kush abstenon?

### **Zamir Muzhaqi-Nënkryetar i Këshillir bashkia Elbasan**

Keni 2 propozime një prpozim është që të hiqet pika 8 dhe propozimi i dytë është së ka folur dhe Tani ka folur dhe ergysi dhe propoimi i dytë është që si material mos kalojë i bashkangjitemi Ilirit dhe ta bëjmë këtë diskutim serioz sepse është për tu bërë serioz.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Votimi parë kush është që të hiqet nga rendi ditës,kush është kundra?

### **Valbona Balliu-Anetar i Keshillit Bashkiak Elbasan**

Kjo ishte shfaqje epike

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Mundësisht mund të mbani kartonat në dorë

### **Doris Madhi-Anetar i Keshillit Bashkiak Elbasan**

Ja gjithë kjo dorë nuk ju del.

### **Ergys Muzhaqi-Anetar i Keshillit Bashkiak Elbasan**

Po vdes gjysma Elbasanit nga kanceri jeni në terezi apo jo.

Këshilli Bashkiak me 28 vota pro, kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 04.03.2025, ora 11:22 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Zv.Kryetari i Bashkisë Z.Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Pika e dytë e rendit të ditës**

**2.Miratimi I proçes verbalit të muajit janar 28.01.2025 dhe I shkurtit 10.02.2025.**

#### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kush është pro?

#### **Doris Madhi-Anetar i Keshillit Bashkiak Elbasan**

Përsa I përket proçes verbalit të janarit ta kam bër vërejtjen edhe ditën e komisioneve po ta bëj vërejtjen edhe sot ,ka pas momente që ca nga këshilltarët ton nuk kanë qenë fare në sallë por është votuar ,duhet të shënohet në proçes verbal kush nuk ka qenë present në sallë që ska votuar ,jo vetëm numri total I votave pro apo kundër .Për këtë arsye proçes verbali nuk është transparent dhe nuk është I vërtetë pra e humb qëllimin e tij .Për shkurtin keni bër një gjysë paqe narrative për proçes verbalin e shkurtit për një çështje shumë të rëndësishme që e hodhët me super emergjencë në një mbledhje on line që nuk duhet të ekzistonte sepse e kemi lënë që vendimi qarkullues mëtej vetëm në raste ekstreme siç janë ndihmat ekonomike për mos të prishur vazhdimësinë e jetës qytetarëve .Unë pretendoj që në proçes verbalin e shkurtit të pasqyrohet e gjithë biseda që është bërë në grupin e WhatsApp-it të këshillit bashkiak,në të kundërt të dy proçes verbalet nuk I realizojnë objektivat që kanë për të qenë transparent dhe të vërtetë dhe nuk pasqyrojnë as fjalën e atyre që mund të jenë këshilltarë bashkiak kështu që ju lutem pasqyroni proçes verbalet për vërtetësi ,proçes verbale të tilla mund të nënshtrohen edhe pjesës së trajtimit nga ana e prokurorisë sepse nuk janë të vërteta.Unë nuk e ngre dorën për këto proçes verbale sepse nuk e gjej fjalën time këtu.

### **Erion Murataj-Anetar i Keshillit Bashkiak Elbasan**

Ky këshill bashkiak ka për detyrë transparencën publike,unë e kuptoj që pjesa më e madhe këtu nuk e ka marrdhënien drejtpërdrejtë me votuesin ,e ka për shkak të partisë por kjo nuk do të thotë që ne të luajmë mendsh të gjithë dhe sepse I do qejfi apo xhepi kryetarit te bashkisë apo juve për të kaluar një projekt ,te letra është 600.000 euro por mbrapa fsheh 4.6 milionë euro ,nje mega projekt që do të zhvillohet ku ky është piloti që flasim së pari ,ne ta kalojmë pa shumicë në ëhats up.Në ëhats up unë nuk e di se kush ja merr telefonin nga dora anëtarit të këshillit ja merr fëmija ,ja merr komshiu,ja merr kryetari I bashkisë .Eshtë një votim që ndikon drejtpërsëdrejti pronën private sepse pallatet që janë Godina 5 katëshe janë prone private siç është edhe trualli.Është një marrdhënie sa juridike aq edhe sociale që do të thotë një mazhorancë e majtë që pretendon të ketë ndërgjegjjen personale të masës jo vetëm që sduhet ta sjelli me emergjencë këtë por duhet ta sjelli me konsultim të mirëfilltë publik,të gjej dakortësinë e atyre që preket dhe në fund fare të vij këtu edhe ta votojë.Kjo e proces verbalit të shkurtit do shkoj ne prokurori dhe po e deklaroj që do ta çoj unë bashkë me këtë proces verbal që kam në dorë sot.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Do tju ftoja secilin nga anëtarët qe ka probleme me proces verbalet,sekretaria është aty dhe mund ta depozitojë apo mund ta kontrollojë sepse gjithçka ka qenë e regjistruar në rrjetet sociale.Të gjitha mbledhjet janë të regjistruara.Ëhats up është një nga format që votohet kur thuhet online.Kur thuhet online do të thotë që ti je ose sje present.Kush është pro proces verbaleve të janarit dhe të shkurtit?

### **Proces verbali 29.01.2025**

Këshilli Bashkiak me vota 29 pro,2 kundër, 1- abstenim, miraton sa më sipër.

V.K E.Murataj,A.Kana

V.A E.Muzhaqi

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



**Proçes verbali 10.02.2025**

Këshilli Bashkiak me vota 25 pro, 14 kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

(V.K.D.Madhi,V,Balliu,R.Mita,A.Marku,D.Cepa,E.Muzhaqi,A.Kana,Y.Balliu,  
A.Mecja,A.Domi,B.Copja,E.Murataj.A.Murati,Z.Muzhaqi)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 04.03.2025, ora 11:22 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Pika e tretë e rendit të ditës**

### **3. Mbi emërimin e sekretarit të Këshillit Bashkiak**

#### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Në bazë të ligjit 139.2015 si dhe rregullores së këshillit Bashkiak sekretari miratohet nga këshilli dhe emërohet nga Kryetari I Këshillit .Emërohet Z.Sokol Sinani ish anëtar prej shumë vitesh .Ka mbaruar Un.Aleksander Xhuvani,ka master per sherbim prove dhe ekonomia dhe e drejta.Ka punuar ne sektor privat ,ne komunen e Shushices dhe të Gjinarit,si dhe në qendrën profesionale.Unë propozoj që të votohet për sekretar këshilli një njeri që do realizoj të gjitha detyrat që do I japi Këshilli.Sa vota janë pro?

Këshilli Bashkiak me vota 29 pro, 1 kundër, 3- abstenim, miraton sa më sipër.

(V.K.E.Murataj)

(V.A.R.Mita,D.Cepa,A.Domi)

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 04.03.2025, ora 11:22 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Pika e 4 dhe 4.1 e rendit të ditës**

**4 .Mbi miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i bashkisë për muajin Janar 2025.**

**4.1. Mbi miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Janar 2025.**

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kush është pro? Do ta relatoj.

Këshilli Bashkiak me vota 35 pro, 1 kundër, 1- abstenim, miraton sa më sipër.

(V.K.E.Murataj)

(V.A.E.Muzhaqi)

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 04.03.2025, ora 11:22 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Pika e 5 dhe 6 e rendit të ditës**

**5. Mbi propozimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike.**

**6. Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë.**

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Pika 5 mbi propozimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi I kushtëzuar ,e njehta gjë edhe pika 6. Ka nevojë ndonjë për shpjegim?

### **Miranda Duka-Anetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Bazuar në ligjin e ndihmës ekonomike të vitit 2019 të nenit 21, ligji na detyron që çdo fillim viti të bëjmë miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për fondin e Bashkisë dhe fondin e kushtëzuar. Ne kemi klasifikuar kriteret të cilat I kemi të shkruajtuara aty, për familjet në nevojë të cilët nuk kanë mundësi mund të aplikojnë tek sistemi pasi kanë anëtarë të familjes jashtë shtetit, janë të braktisur apo janë në moshë të vjetër dhe nuk përfitojnë dot nga sistemi I ndihmës ekonomike.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ka njeri pyetje?

### **Erion Murataj-Anetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Janë disa propozime që qendrojnë por janë edhe disa propozime që nuk qendrojnë psh në Elbasan janë 5-6 raste që unë kam referuar ku është hequr ndihma ekonomike nga një inspektim që vjen nga ministria pse ka patur një dhi apo një motor kryefamiljari. Kto familje nuk mund të paragjykojnë kështu. Bashkia duhet të gjejë të

gjitha elementët ligjorë që ti shikojë rast pas rasti kto.Kjo lista e cila here hiqen e here vihen duhet të ketë nje stopim duke qen se jemi në prag elektoral nga heqja e listes se ndihmës ekonomike për shkaqe të ndryshme apo si do qejfi drejtorit të njësisë.Ne si këshill bashkiak duhet të ndërhyjmë tek drejtoria përkatëse në Bashki e të themi se nga tani e mbrapa mund të hyjmë në skemë por ti apriori deri ne përfundim të zgjedhjeve nuk mund të përjashtosh asnji.

### **Miranda Duka-Anetar i Keshillit Bashkiak Elbasan**

Familjet që aplikojnë në system Bashkia Elbasan nuk është organi vendimarrës.Ne bëjmë aplikimin në system dhe organi vendimarrës për këtë është Drejtoria rajonale e shërbimit social ku nëpërmjet formulës së pikëzimit ato nxjerrin listen përfituese dhe listen e refuzuesve dhe refuzimet ne nuk mund ti përjashtojmë dot për arsye nga më të ndryshmet psh personi ka filluar punë dhe ne nuk mund ti japim edhe ndihmë ekonomike apo raste të tjera.Nuk merr dot ndihmë ekonomike se është muaji electoral ose mund të ketë bërë një investim,më përmendët rastin që ka blerë një motor,ndihma ekonomike mesatare për një familje prej 4 personashk është 100 mijë lekë mesatarisht po flasim ndërko që një motor minimumi kushton 300 mijë lekë tani ky quhet investim

### **Erion Murataj-Anetar i Keshillit Bashkiak Elbasan**

Po te blesh një gomoar si quhet?

### **Miranda Duka-Anetar i Keshillit Bashkiak Elbasan**

Për cdo investimi që bëhet të bëhet deklarimi.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kush është pro?Kundra?Abstenim?


Këshilli Bashkiak me vota 26 pro, 4 -kundër, 3- abstenim, miraton sa më sipër.

(V.K.E.Murataj,D.Madhi.A.Kana,V.Balliu)

(V.A.A.Mecja,A.Domi)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 04.03.2025, ora 11:22 në ambientet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Pika 7 e rendit të ditës**

**7.Për vendosjen në institucionet rezidenciale të shërbimeve sociale Znj. Fatmire Musabelliu dhe Z. Fatos Avdiaj.**

Këshilli Bashkiak me vota 32 pro, -kundër, 3- abstenim, miraton sa më sipër.


(V.A.E.Murataj,D.Madhi)

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 04.03.2025, ora 11:22 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Pika 8 e rendit të ditës**

#### **8. Monitorimi i buxhetit për katëmuajorin e tretë të vitit 2024 (progresiv vjetor).**

##### **Shefqet Bullari-Anetar i Keshillit Bashkiak Elbasan**

Bashkia ka paraqitur një raport analitik për monitorimin e buxhetit për 4-mujorin e 3-të dhe vjetor progresiv. Ky buxhet është hartuar në mbështetje të akteve ligjore dhe buxheti I vitit 2024 kishte si objektiv që të mbulonte gjithë territorin e bashkisë me shërbime cilsores me qëllim përmirsimin e jetës së qytetarëve dhe kishte disa objektiva për të përmirësuar infrastrukturën rrugore të rrugëve urbane dhe rurale ,për të përmirësuar shërbimin e pastrimit në gjithë territorin ,për rritjen e sipërfaqeve të gjelbra,për mirmbajtjen e tregjeve,mbrojtjen e tokave bujqesore ,kullimin ,mbulimin e territorit me shërbime sociale,kulturore dhe sportive,menaxhimin e katastrofave të ndryshme .Janë 9 programe që janë paraqitur në mënyrë analitike nga administrata,mbështeten funksionet dhe aktivitetet për çdo program ku pasqyrohen shpenzimet e planifikuara për çdo veprimtari për projektet e planifikuara dhe për shërbimet e kryera.Një vend të rëndësishëm në buxhet zë realizimi I të ardhurave.Kemi një analizë të hollësishme për çdo zë të buxhetit ,në total të ardhurat për vitin 2024 janë realizuar në masën 67%,ka një rritje 13% krahasuar me vitin e kaluar por ka edhe probleme si taksa e ndikimit në infrastrukturës cila realizoi 40%.Shpenzimet janë pasqyruar në tabelën analitike për 9 programet dhe në total janë realizuar 72%,nga të cilat pagat dhe sigurimet janë pasqyruar 90%.Shpenzimet operative realizohen në masën 77% ,transferta 24%,investimet 51% .Në peshë specifike janë kta tregues ,shpenzime për paga në total të buxhetit zënë 52% të totalit,shpenzimet operative 32%,shpenzime për investime 15% dhe transferta 1%.Shpenzimet janë pasqyruar për çdo grup të ardhurash dhe transfertash.Për çdo program kemi objektivat realizimet shërbimet e kryera në mënyrë analitike.Gjithashtu janë pasqyruar edhe investimet.Ky raport eidenton punën e Bashkisë për vitin 2024 ku analizohen objektivat e caktuara ku pasqyrohet niveli I

cilësisë dhe shërbimeve të kryera, njëkohësisht konstatohen edhe mangësitë dhe ato duhet të analizohen me përgjegjësi gjatë vitit 2025 duke rritur më shumë performancën në punë të Bashkisë duke rritur edhe të ardhurat e viti 2025.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ftoj anëtarët e këshillit ta miratojnë

### **Erion Murataj-Anetar i Keshillit Bashkiak Elbasan**

E para ky raport është gënjeshtër .Unë kam 2 plane pune të javës së kaluar për ASHPR-në. Te gjitha raportet javore janë fiktive. Ju keni bërë një projekt pilot fasadë që keni harxhuar edhe të ardhura nga taksat e qytetarve ku tre muaj pasi ka mbaruar buxheti me pjesmarrje jeni 0. Kta zoterinjtë ktu ju kanë votuar për shtet jo për tju marrë taksat. Për sa kohë nuk dini të administroni, doni të vidhni, qytetarit mos I merrni taksa merrni fondet e BE që vijnë ktu për të cilat bëni projekte për ndriçim ,për energji të gjelbër, për korsitë biçikletash apo 80 taksist taksapagues të Elbasanit ti detyroni të marrin taksë elektrike, të heqin bukën e fëmijëve, të hyjnë kredi në bankë sepse juve doni ti bini qylit. Përsa kohë sillni raporte të tilla të cilat I mbron vetëm me pagat tuaja mos I sillni fare.

### **Doris Madhi-Anetar i Keshillit Bashkiak Elbasan**

Një analizë të ngjashme unë e bëra në momentin kur ne votuam dhe na u vu përpara projekt buxheti I vitit 2025 dhe I qendroj asaj që thash për buxhetin e 2024. Po të shikosh zërat e shpenzimeve sepse spo ndalem tek të ardhurat që janë realizuar 67%, ato që të bien në sy janë ato sektorë që janë më pak të kontrollueshëm. Flasim për mbrojtjen e mjedisit 90% e realizimit, ndërkohë ju kujtoj një shifër 220 milion lekë të hedhura për mbjelljen e fidanëve të rinj, që ne nuk dime as ku as sa as kur as si , dhe kur kemi kërkuar informacion na ka ardhur informacion nga agjensia e mjedisit ku thotë kta fidanë janë mbjellë nga donatorët, vazhdoj bëj pyetjen ku janë 220 milion lekë dhe pse realizohet 90% shpenzimi këtu, ndërkohë që gjithsej ka patur 361.600.000 lekë? Shpenzimet operative, momenti realizimit të të gjitha atyre që duhet të ishin prokurime publike, mungojnë më tepër se 1.8 miliard lek që duhet të ishin prokuruar, ku janë rishpërndarë në këtë buxhet? Nuk janë prokuruar, 360 milion lekë kemi një vit e gjysëm që vijmë vërdallë, ca bëjnë modele, ca thonë na e kanë kthyer mbrapsht procedurën e prokurimeve se ka ankime. Të ndërthurësh Shifra në finance është shumë e lehtë por ë bësh transparencë mbi kto shifra është tjetër

histori.Dhe transparenca është kjo:prokurimet publike nga një krah pra investimet publike që I keni realizuar në masën 9% dhe mungojnë 1.8 miliard lek që nuk janë në gjendje në arkën e Bashkisë.Ato investime që nuk jan realizuar ku janë?

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Të diskutojmë për çështjet e rendit konkret,jam dakort me atë që fole por jo merr një temë e kalon në çështje të tjera

### **Emanuela Beluli-Anetar i Keshillit Bashkiak Elbasan**

Raporti është monitoruar në bazë të thesarit.Nuka ka manipulime,shifrat janë të sakta,janë të ardhura dhe shpenzime faktike ku janë pjesë e bilanceve

### **Zamir Muzhaqi-Nënkryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Keni 20 vjet ne pushtet,e bastarduat.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kush është pro?

### **Artan Kana-Anetar i Keshillit Bashkiak Elbasan**

Se kuptoj se në cfarë realiteti jeton pozita ,fjala duket qartë në çdo mbledhje këshilli,në çdo votim për iceneratorin ku nuk I dalin për Zot.Jeta qytetarve vetëm përkeqsohet në fshat apo qytet dhe ato prap thonë ne jemi duke shkuar në Shqipërinë 2030 ne jemi në hapa të sigurtë.Ne po ju nxjerrim realitetin siç është.Qytetarët Shqiptarë janë në kënetë.Ne monitorim keni një rritje prej 9% por kjo vjen si pasoje se ju vjet rritët me 25% tarifën e gjelbërimit pastrimit dhe ndriçimit,keni bllokuar llogaritë bankare pa të drejtë, pa I lajmëruar dhe përgjithsisht janë familje të reja.Njerëzit kan marr borxh për të lar lekët.Rrugët e Elbasanit lën për të dëshiruar,90% të buxhetit keni realizuar rroga dhe 50% janë në formë investimi,në fakt duhet të jete kundërta.Edhe familjeve që marrin ndihmë ekonomike nuk I keni rritur një lek,ato jan familje në nevojë,një shtet kujdeset peër të varfërit kurse ju kujdeseni për të fortët.

### **Asim Sula-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ju e dini funksionin dhe rolin tuaj. Jemi në pikat të raportit të monitorimit të buxhetit. Nëse shkojmë te konteksi politik nuk marrim vendim të saktë. Të gjitha sygjerimet tuaja do të merren parasysh nga Bashkia.

### **Valbona Balliu-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Pikë së pari buxheti ishte ku thërret qameti. Shërbimet operative janë baraz me investime dhe paradoksi është shpenzimet operative kryhen në masën 77% dhe realizohen ato sepse aty është paraja, aty vidhet lehtësisht ndërsa investimet I ke në masën 51%. Agjensia e prokurimeve publike I ka transparente të gjitha kërkesat, të gjitha tenderimet. Në vitin 2024 ishin parashikuar 2 miliardë investime dhe ktu mungojnë pikërisht ato para se sot tik e gjendje 860 milion, pra ktu investime prej 2 miliard lekësh ti nuk I ke kry, ku kanë shkuar ktu lek, duhet të kishe minimalisht në buxhtin e shtetit 2 miliard lekë se nuk I ke kry ato prokurime. Rotonda është skandaloze, asaj nuk I është vënë një tulle. Pse nuk është hapur gjimnazi? Se ska banka, ti ke vë ktu që janë harxhuar 140 milion lek për banka e për kancelari dhe për mirmbajtje objekti. Është turp I vërtetë që gjimnazet bëjnë shkollën natën, morët në qafë një gjeneratë të tërë, dëmtuat cilsinë e arsimit, ky është problem ku shkojnë lekët?

### **Emanuela Beluli-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Në zërin e shpenzimeve operative futen ndriçimi, gjelbërimi, pastrimi, mirmbajtja e shkollave etj, peshë të madhe zëjnë mirmbajtja e rrugëve, funeralet, ngrohja në shkolla, nafta, etj kurse nërin e investimeve që nuk janë realizuar, nëse nuk realizohet plani I të ardhura ska se sit ë realizohet plani I shpenzimeve. Jam ktu për realizimin e shpenzimeve faktike.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kush është pro?

Këshilli Bashkiak me vota 28 pro, 9-kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

(V.K.E.Marataj,A.Mecja,A.Domi,E,Muzhaqi,A.Kana,Y.Balliu.A.Murati,D.Kana,R.Mita)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 04.03.2025, ora 11:22 në ambjentet e qëndrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Pika 9 e rendit të ditës**

#### **9. Korigjim (saktësim) i burimit të financimeve në buxhetin e vitit 2025.**

##### **Shefqet Bullari-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ka një korigjim Teknik ne buxhetin e vitit 2025, në 22 janar 2025 uzina e lëndëve plasëse ka derdhur taksa të prapambetura 86 milion lek të cilat derdhjet deri më 27 janar quhen të ardhura nga viti 2024 dhe në bazë të udhëzimit të ministris së financave për këtë qëllim është e domosdoshme që këto të ardhura të shtohen për vitin 2025 si të ardhura të trashëguara dhe të pakësohet plani I të ardhurave nga arkëtimet e debitorëve .

##### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ka ndonjë pyetje? Kush është pro?

Këshilli Bashkiak me vota 27 pro, 1-kundër, 2- abstenim, miraton sa më sipër.

(V.K.E.Murastaj)

(V.A.A.Murati)

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 04.03.2025, ora 11:22 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Pika 10 e rendit të ditës**

**10. Për propozimin e rikonceptimit të Këshillit Vendor për sigurinë publike bazuar udhëzimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 678, datë 30.10.2024.**

#### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kalojm tek Pika 11 për propozimin e rikonceptimit të këshillit vendor të sigurisë publike .Doni ndonjë sqarim?

#### **Kristina Kreka-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Bashkia Elbasanit operon prej vitesh në këshillin vendor të sigurisë publike ,sot jemi per rikonceptim të anëtarëve bazuar në VKM për të cilat gjithë njësit e vetqeverisjes vendore riorganizojnë strukturën e tyre si një lloj mekanizmi që drejtohet nga Kryetari I Bashkisë dhe bazuar në këtë VKM prefekti në rang qarku organizon të gjitha njësitë e vetqeverisjes vendore për të raportuar pranë prefektit 3 ditë para marrjes së vendimeve për pjesën e procedurës së aktiviteteve të kosultuara nga ky mekanizëm Mekanizmi I sigurise publike do të vazhdoj të funksionojë dhe do të vazhdoj të drejtohet nga Kryetari I Bashkisë.

#### **Ergys Muzhaqi-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kto janë caktuar në VKM?Mesa ve re tek ky ndryshim që është bër ,nuk është se ka ndryshuar ndonjë gjë në thelb, është një ndryshim Teknik që nuk qendron.Ky këshill është themeluar për here të pare në Elbasan në bashkëpunim me OSBE dhe strukturat e tjera ndërkombëtare,Në propozimin e ri që na vjen këtu pika më thelbësore është ajo që unë mora një teknike,janë hqur strukturat të rëndësishme si prokuroria,fuqia civile etj dhe janë future si anëtarë të këshillit të sigurisë vendore vetëm përfaqshues nga institucionet që kanë varësi nga qeveria apo nga bashkia,gjithë të tjerët kanë ik.I

vetmi ndryshim ky është,dhe po e deklaroj që tani votën time kundër, është jashtë kontekstit që u ngrit ky këshill në rradhë të pare.

### **Zamir Muzhaqi-Nënkryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Vërejtjes që bëri Ergysi nuk dua ti heq asnjë presje.E sillni në këshillin bashkiak propozimin për miratim dhe përveç faktit se keni bërë krasitje të disa institucioneve shumë të rëndësishme të cilat qen edhe institucione nismëtare të këshillit,e sillni edhe minimalisht kryetari I këshillit bashkiak nuk është pjesë e ktij këshilli.Jemi non grada si këshill,bejmë këshille që ti kalojmë ne si këshill edhe përjashtojmë veten tone ,ktë e kam për kolegët e mi.

### **Eva Bica-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

VKM-në je I detyruar ta zbatosh

### **Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Përtej VKM-së,në monitorim të këshillit vendor të sigurisë publike si një mekanizëm I ngritur nga Bashkia Elbasan në tetor 2016 është cituar që do të jetë mekanizma monitorues,anëtarët e këshillit bashkiak,organizatat e shoqërisë civile, universiteti,prokuroria,sepse bashkia Elbasanit e ka nisur ktë model me një trekëmbësh,drejtuar nga Kryetari I Bashkisë,prokuroria dhe policia.Kta mekanizma që nuk janë pjesë e VKM-së do të jenë në monitorim të planit të aktiviteteve që do të ndërmarrë këshilli vendor I sigurisë publike dhe kjo do të jetë risia e implementuar nga bashkia Elbasan

### **Bukurosh Stafa-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Unë jan dakort me vendimin e këshillit të ministrave por ne si këshill të propozojmë të shtohen ato institucione apo shoqata e të marrin pjesë në mbledhjen e këshillit

### **Ergys Muzhaqi-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kështu është propozimi le të vijnë të shofin.Sot janë antarë prokurori,punonjës I gjendjes civile,këshilli bashkiak dmth kto janë përjashtuar nga antarësia e thonë rrini aty dëgjoni ça po themi ne,edhe ne si këshill bashkiak jemi përjashtu pra është bër një propozim që ne dalim jasht loje të mos kemi përfasues antarë po të jemi vëzhgues dhe prokurori,aktivitet fetare etj të jen monitories dhe nuk është një reagim Teknik ndaj jush por është një reagim politik

**Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kush është pro?

Këshilli Bashkiak me vota 25 pro, 12-kundër, 2- abstenim, miraton sa më sipër.

(V.K.E.Murataj,A.Domi,A.Mecja,E.Muzhaqi,A.kana,Y.balliu,A.Murati,D,Madhi,  
V.Balliu,Z.Muzhaiqi,D.Cepa,R.Mita)

(V.A.E.Ferra,E.Bardhi)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 04.03.2025, ora 11:22 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Pika 11 e rendit të ditës**

**11. Informacion mbi nxjerrjen jashtë përdorimi të materialeve të (aseteve shkollore), për vitin 2024.**

Këshilli Bashkiak me vota 25 pro, 1-kundër, 6- abstenim, miraton sa më sipër.

(V.K.E.Murataj)

(V.A.E.Muzhaqi, V.Balliu, R.Mita, A.Kana, A.Murati)

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 04.03.2025, ora 11:22 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Te ndryshme**

**1. Memo drejtuar Këshillit të Ministrave për krijimin e një Landfilli të ri, propozuar nga anëtarë të Këshillit Bashkiak**

**2. Mbi miratimin në parim të marrëveshjes së projektit: Qendra Multifunktionale Ditore për të Moshuarit.**

#### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ne mbledhjen e ardhshme të kemi diçka konkrete, të jetë materiali I përgatitur.

**2. Miratimi në parim i marrëveshjes së projektit-Qendra multifunktionale ditore për të moshuarit**

#### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kush është pro? Kush do shpjegojmë unë ju pyeta

#### **Asim Sula-Nënkryetar i Bashkisë Elbasan**

Bëhet fjalë për ngritjen e 4 qendrave rezidenciale për të moshuar, do jen qendra ditore që të moshuarit do shkojnë e do marrin shërbime fizioterapie, psikologjie. Ky është një projekt I financuar 60% nga ministria e shëndetësis dhe 40% nga bashkia. Ne e konsiderojmë ngritjen e ktyre qendrave sit ë rëndësishme përpos kushteve aktuale ku të moshuarit kanë nevojë, kur janë edhe të vetmuar, ku mund të kalojnë kohën dhe të marrin shërbimin e dëshiruar.

#### **Doris Madhi-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Pyetja 1-Në lek, sa është kostoja e bashkisë në këto qendra?

Pyetja 2-Të punuarit në këto qendra që do ofrojnë shërbime jo vetëm fizioterapie, aerobie, joga dhe ato gjërat e tjera që mua më bëjnë për të qeshur, se do

preferoja ti jepeshin ndonjë shërbimi spitalor apo ti rimburoheshin ilaçet. Kta persona që do jenë të punsuar aty do jen me kohë të pjeshme apo të plotë.

### **Asim Sula-Nënkryetar i Bashkise Elbasan**

Jane 4 qendra që do të hapen që kanë nevojë për staf sigurisht që ka staf me specifikimet e veta dhe për këtë drejtoresha e shërbimeve socialeve do të japi shpjegimet dhe detajet e hollësishme .

### **Eltiona Kolla-Përfaqesuese e Administratës së Bashkisë**

Nuk jan qendra rezidenciale por jan qendra për të moshuarit. Mosha e tretë është një target grup që duhet ndihmuar. Ka të bëj me 4 qendra që do hapen në 4 lagje të qytetit që do të jenë në shërbim të të moshuarve për tu socializuar dhe për të kaluar kohën e lirë, siç ka qen qendra Balashe por përtej kafes do ken edhe shërbime të tjera, pot dhe jo pse jo mendoj se i vjen në ndihmë.

### **Doris Madhi-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Po flasim për persona të marginalizuar të shoqërisë shqiptare, që janë pensionistët, ka pensionistë që jetojnë me 80 euro dhe në këtë sens të ngresh qendra për joga, aerobi mua më duket tallje . Un jam shumë e lumtur që po krijohen kto 4 qendra por do të isha Akoma më e lumtur nëse në kto qendra do ofrohej ajo që kanë nevojë pensionistët, sugjeroj që të futen vaktet ushqimore ktu Brenda Fizioterapistin ta keni nga mëngjesi deri në darkë.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kush është pro?

Këshilli Bashkiak me vota 27 pro, -kundër, 8- abstanim, miraton sa më sipër.

(V.A.E.Murataj, D.Madhi, Y.Balliu, A.Murati, R.Mita, Z.Muzhaqi, V.Balliu, D.Cepa)

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Kishe gjë tek të ndryshmet?

**Erion Murataj-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

U mbyll shumë bukur kjo mbledhje këshilli, me një qendër që ka shtuar punonjës për joga, 450 mij lek rrogë do të thotë një ditë pune e puntorit për të hapur një km rrugë. Jane 4 fshatra, është një kërkesë që kta zotërinjtë ktu duhet ta dëgjojnë.